KEMINET SHPK
Rr: “Abdi Toptani”
Torre Drin No 28
Tiranë. Shqiperi

# KUSHTET E PERGJITHESHME TE DHENIES SE SHERBIMEVE TE SISTEMIT

**Në mbështetje të:**

1. Ligjit nr. 8618, datë 14.06.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligjit nr. 9135, datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”;
3. Ligjit nr.8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
4. Licensës nr.922/0408, datë 16.04.2008 “Për të ofruar shërbime e internetit në Republikën e Shqipërisë” dhënë shoqërisë Keminet shpk nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të Republikës së Shqipërisë”

**1.PËRKUFIZIME**

a) **KEMINET** shpk është shoqëria tregtare me të njëjtin emër e regjistruar si person juridik në Regjistrim Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr. 38303, datë 16 Maj 2007, sipas vendimit me te njejtin numër e të njëjtën datë të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

**b)** **Pajtimtar** është individi, personi fizik ose juridik të dhënat e të cilit gjenden në formularin për pajtim dhe të cilit i jepet e drejta të përdorë shërbimet e Internetit të KEMINET.

**c)** **Paisje fundore e pajtimtarit** është do lloj paisje e miratuar nga autoritetet përkatëse kompetente dhe që është në përputhje me karakteristikat e rrjetit KEMINETIT nëpërmjet së cilës kryhet komunikimi nga pika në pikë.

**d)** **License** është licensa për të ofruar shërbimin e Internetit në Republikën e Shqipërisë, dhënë shoqërisë KEMINET.

**e)** **Sistem** është sistemi i Internetit instaluar nga KEMINET në përputhje me ofetën per të ofruar shërbimin e Internetit, i cili vihet në punë sipas kushteve të licensës së dhënë Keminet.

**f)** **Lista e çmimeve** është lista e çmimeve të shërbimeve të sipërpërmëndura të Internetit ose të shërbimeve të tjera që kanë lidhje me këtë sistem, të nxjerra nga KEMINET dhe të vëndosura prej KEMINET në bazë të së drejtës së KEMINET për të vendosur ose ndryshuar tarifat për shërbimet e dhëna nga sistemi.

**g)** **Tarifa e Lidhjes me Rrjetin** është shuma që paguhet nga Pajtimtari për Lidhjen e Pajtimtarit me rrjetin KEMINET dhe për rregjistrimin e tij në këtë rrjet në datën e pranimit të formularit të kërkesës për pajtim.

**h)** **Tarifa Mujore Fikse** është shuma që faturohet Pajtimtarit nga KEMINET çdo muaj me parapagim për mbajtjen e tij në rrjetin KEMINET në përputhje me listën e çmimeve, që nga data e pranimit të formularit të kërkesës për pajtim.

**i)** **Lidhje** është lidhja e paisjes fundore të pajtimtarit me sistemin.

j) **Ndërprerje/bllokim** është heqja e përkohshme e së drejtës së Pajtimtarit për të përdorur shërbimet KEMINET, por jo edhe i lidhjes me rrjetin KEMINET, e cila mund t’i rikthehet përsëri në kushte të caktuara.

k) **Shkëputja** është heqja përfundimtare e së drejtës së Pajtimtarit për të përdorur shërbimet KEMINET bashkë me lidhjen e tij.

l) **Afati fillestar** është afati kohor më i shkurtër, 3 (tre) muaji i kontratës

**2. PRANIMI I KËRKESËS PËR PAJTIM**

a) Çdo individ, person fizik ose juridik, ka të drejtë që brenda një afati të arsyeshëm nga koha e paraqitjes së kërkesës së tij për pajtim dhe radhës së kërkesave, të përdorë lirisht dhe pa dallim shërbimet e Internetit qe jepen në përputhej me kushtet e liçensës dhe KEMINET ka të drejtë të marrë masa ligjore objektive dhe të paanshme për t’u mbrojtur nga rreziku i borxheve të këqija, masa të cilat duhet të merren në përpjestim të drejtë me rrezikun.

b) KEMINET është i detyruar të japë vetëm ato shërbime dhe vetëm në zonën e mbulimit sipas përcaktimeve të Liçensës, në përputhje me këto kushte dhe Formularit për Pajtim, me kusht që formulari të jetë i nënshkruar nga Pajtimtari në përputhje me ligjin dhe të jetë pranuar nga KEMINET.

c) KEMINET duhet t’i kthejë përgjigje të shpejtë kërkesës për pajtim. KEMINET ka të drejtë që gjatë fazës parakontraktore, të kërkojë të dhëna për adresën dhe identitetin e pajtimtarit të ardhshëm, si fotokopje të letërnjoftimit, të pashaportës për jashtë shtetit, të librezave të telefonit ose të energjisë elektrike ose dokumente të tjera, kur ai është person fizik dhe, dokumente që provojnë identitetin e tij, kur ai është person juridik dhe mund të kërkojë, gjithashtu, informacion për deklaratat tatimore ose dokumente të tjera të ngjashme me të, në mënyrë që të verifikojë aftësinë paguese të pajtimtarit dhe të marrë vendime për të kredituar ose jo shërbimin ose të veprojë, sipas rastit, duke shmagur ose konstatuar aktet e paligjshme.

**3. LIDHJA ME SISTEMIN/DHËNIA E SHËRBIMEVE**

Në përputhje me kushtet e mësipërme KEMINET do të realizojë lidhjen dhe mbajtjen në sistem të paisjeve fundore të Pajtimtarit dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për dhënien e shërbimeve Pajtimtarit deri në përfundim të kontratës, siç parashikohet në pikën 7, me përjashtim të rastit kur kontrata zgjidhet përapara afatit, siç parashikohet në pikat 14 dhe 15.

Për këtë qëllim, KEMINET do të pajisë Pajtimtarin me pajisje fundore, modem, kabell rrjeti, switch etj dhe do ta njoftojë atë lidhjen e tij, si dhe do t’i japë atij udhëzimin përkatës për përdorimin e shërbimeve.

Pranohet shprehimisht nëpërmjet këtij dokumenti se Pajtimtari nuk fiton të drejtat mbi pajisjet e kompanise. KEMINET mban përgjegjësi vetëm për zevëndësimin e pajisjeve të dëmtuara, me përjashtim të rasteve kur këto dëmtime vijnë si rrjedhojë e veprimeve të pakujdesshme ose të vullnetshme të Pajtimtarit. Pajtimtari përgjigjet civilisht ose penalisht për përdorimin e pajisjeve te KEMINET në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin dhe është i detyruar që në rast humbjeje, vjedhjeje.

Në të gjitha rastet e mësipërme dhe në rastin kur pajisjet që sigurojne Internetin, prishen, për arsye që nuk varen nga KEMINET Pajtimtari detyrohet të njoftojë menjëherë KEMINET.

Në rast se lidhja me rrjentin KEMINT qëndron e palidhur në rrjet ose pushojnë së qeni të lidhura për arsye të ndryshme për gjashtë (2) muaj radhazi, KEMINET mund t’i tërheqë pajisjet dhe t’ia kalojë ato një personi të tretë, pa mbajtur përgjegjësi. Në datën e shuarjes së lidhjes përdorimi i Internetit zgjidhet automatikisht edhe kontrata në lidhje me këtë numër.

**4. TARIFAT**

KEMINET do të përcaktojë përmbajtjen e faturave, me kusht që në këtë informacion të mjaftueshëm për Pajtimtarin në mënyrë të tillë, që të llogarisë shumën e duhur që do të faturojë për të gjitha shërbimet e dhëna sipas llojit të tyre. Pajtimtari faturohet në përputhje me listën e çmimeve që është në fuqi, sipas rastit. KEMINET ka të drejtë që, herë pas here, të zbatojë një pjesë ose të gjithë listën e çmimeve në fuqi të KEMINET, e cila mund të ndryshojë në përputhje më gërshetimin e faktorëve të mëposhtëm: inflacionin, koston e investimit, koston e shërbimeve të dhëna nga rrjeti, koston e mirëmbajtjes nga rrjetit, ndryshimin e herëpashershëm të kritereve të legjislacionit në fuqi si dhe rregullat e konkurencës së ndershme. Njoftimi për rritjen e tarifave mund të hyjnë në fuqi menjëherë.

KEMINET ruan të drejtën për të përcaktuar kushtet dhe afatet për pjesmarrjen e pajtimtarëve në odertat promocionale.

KEMINET ka të drejtë të kërkojë pagimin e faturave me kartë krediti të lëshuar nga një bankë kombëtare ose ndërkombëtare ose në forma të tjera pagese të përcaktuar në Formularin për Pajtim. Pavarsisht nga mënyra e pagesës e përcaktuar nga formulari i Pajtimit, pranohet në çdo rast pagesa me para në dorë ose transfertë bankare. Kur pajtimi mbaron pas kalimit të afatit fillestar 3 (tre) muaj, ose kur shërbime të caktuara nuk jepen më, garancitë e vendosura në mënyrë të arsyeshme nga KEMINET dhe të dhëna nga pajtimtari, do t’i kthehen atij, pa interes, kur Pajtimtari nuk ka detyrime ndaj KEMINET të cilat shlyhen duke i mbajtur nga garancia e dhënë.

**5. MËNYRAT E PAGESËS**

a) Pajtimtari detyrohet t’i paguajë KEMINET, në formë parapagimi ose pas dhënies së shërbimeve, tarifat e mëposhtme:

1. Tarifën e lidhjes me rrjetin (parapagim)
2. Tarifën mujore fikse (parapagim)

si dhe tarifat për shërbimet shtesë të dhëna nga KEMINET, të cilat parashikohen me hollësi në fletën e udhëzimeve në përputhje me kontratën me Pajtimtarin për mënyrën e dhënies së shërbimeve, sipas listës së çmimeve në fuqi.

KEMINET do të faturojë shërbimet në çdo muaj. Pajtimtari është i detyruar të paguajë brenda 12 (dymbëdhjetë) ditëve nga data e lëshimit të faturës sipas mënyrës të kërkuar nga KEMINET: me të holla në dorë, me pagesë bankare, me kartë krediti ose mënyra të tjera pagese. Pajtimtari merr dijeni që nga ky cast mbi lëshimin e faturave mujore e faturave të konsoliduara që rezultojnë nga qendra kompjuterike KEMINET të cilat jepen në bazë të përdorimit të Internetit, që lidh pajtimtarin me rrjetin. Faturat i lëshohen sipas tarifave të përdorimit të Internetit dhe në përputhje me listën e çmimeve në fuqi dhe përfshijnë të gjitha tarifat fikse dhe tarifat e shërbimeve të tjera shtesë dhe janë provë e plotë e detyrimit të Pajtimtarit ndaj KEMINET. Pajtimtari heq dorë në mënyrë të shprehur nga kundërshtimi i shumës që tregon fatura mujore, në rast se nuk ka bërë kundërshtim me shkresë dërguar KEMINET brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e lëshimit të faturës.

b) Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda 15 (pësembëdhjetë) ditëve nga data e lëshimit të faturës. KEMINET mund të ndërpresë lidhjen e Pajtimtarit me sistemin;

Për të gjitha shumat e papaguara KEMINET për më shumë se 30 ditë nga data e lëshimit të faturës fillon të llogaritet sipas përqindjes të interesit nga data e maturimit të pagesës deri në datën e kryerjes së pagesës;

c) Për shumat e mësipërme Pajtimtari do të paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tarifat/taksat e telefonisë së lëvizshme sipas legjislacionit në fuqi;

d) Kur pagesa e faturës kryhet nëpërmjet debitimit të drejtëpërdrejtë të llogarisë bankare, KEMINET nuk mban përgjegjësi për datën e kryerjes së veprimeve nga banka përkatëse;

e) KEMINET do t’i lëshojë dhe dërgojë, pa pagesë, pajtimtarit faturën bazë që përfshin;

- Tarifën mujore fikse, trafikun total;
- Tarifat për njësi shërbimi;
- Llogaritjen e pagesave;
- Detyrimet fiskale;
- Adresa dhe afatet e shlyrjes së faturës;
- Mënyrat e pagesës: me para në dorë, me kartë ose mënyrë tjetër;
- Sanksionet në rast mosshlyerjeje të detyrimeve (kamatë-vonesat, ndërprerje të shërbimeve, kufizimin të shërbimeve, zgjidhje e kontratës nga KEMINET):

**6.KUFIRI MAXIMAL I KREDISË**

KEMINET ka të drejtë të vendosë kufijtë maksimalë për çdo Pajtimtarë dhe t’i ndryshojë ato në rastin kur Pajtimtari kalon nga një plan tarifor në një plan tjetët tarifor. Kur Pajtimtari e kalon kufirin e kredisë KEMINET ka të drejtë :

a) Të ndërpresë /bllokojë shërbimet e dhëna; b) Të lëshojë faturë për pagimin e menjëhershëm të detyrimit.

**7.VLEFSHMËRIA / AFATI**

Afati fillestar i pajtimit është 3 (tre) muaj dhe në mbarim të këtij afati ajo kthehet në kontratën me afat të përcaktuar.

**8.RUAJTJA E FSHEHTËSISË SË KOMUNIKIMEVE ONLINE DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE PERSONALE.**

KEMINET detyrohet të sigurojë fshehtësinë ose karakterin e fshehtë të informacionit ose komunikimit të pajtimtarit.

Konkretisht:

a) KEMINET nuk do të kontrrollojë ose përhapë të dhënat personale ose përmbajtjen e fletëve të Internetit të bëra nëpërmjet rrjetit KEMINET, përveç rastit kur ajo nevojitet si pjesë e veprimtarisë së mirëmbajtjes së rrjetit ose parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

b) KEMINET nuk do të përhapë, transmetojë osë përdorë të dhënat personale të Pajtimtarit, përfshirë (por pa u kufizuar në), përvec rastit kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe ka lidhje të drejtëpërdrejte me dhëniën e shërbimeve dhe/ ose përmbushjen e kësaj kontrate, si dhe rastet kur një gjë e tillë parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

KEMINET do të trajtojë dhe përdorë të dhënat personale të Pajtimtarit për përmbushjen e kësaj kontrate për Qëllimet e Lejuara të Biznesit të përcaktuara nga KEMINET ku përfshihen (por nuk kufizohet vetëm te) përpunimi i kërkesave për pajtimin në rrjet, dhënia e produkteve dhe shërbimeve Pajtimtarit, mbajtja e llogarive të transaksioneve, përgatija e faturave dhe dhënia e shërbimit të kujdesit për klientin, kontrolli dhe raportimi i kreditit, krijimi dhe mbajtja e bazave të të dhënave dhe platformave të shërbimit, kryerja e analizave për informacion biznesi, ristrukturimi apo riorganizimi i biznesit KEMINET, siguria e rrjetit KEMINT dhe e informacionit, mbrojtja e aseteve dhe të drejtave të KEMINET, përfshirë të drejat e pronësisë intelektuale dhe markën tregtare, punonjësit dhe klientët nga aktiviteti kriminal apo aktivitet tjetër që mund të shkaktojë dëm, për të përmbushur detyrime ligjore dhe rregullore në lidhje me proçedurat ligjore, përfshirë dhe mbrojtjen në proçese ligjore kundër KEMINET.

a) Me pëlqimin tuaj, KEMINET mund të publikojë të dhënat tuaja të kufizuara në emër, mbiemër, numër telefoni në numuratorët telefonik publikë që operohen nga KEMINET ose tia kalojë këto të dhëna për publikim çdo operatori tjetër publik i telekomunikacioneve i përcaktuar me ligj për publikim numratori.

b) Për të bërë të mundur përmbushjen e kësaj kontrate, KEMINET ka të drejtë të ndajë baza të dhënash e platforma shërbimesh ku mbahen të dhënat e Pajtimtarit me shoqëri të tjera të KEMINET dhe këto baza të dhënash e platforma shërbimesh.

c) KEMINET merr përsipër të respektojë fshehtësinë dhe privatësinë e Pajtimtarit dhe të trajtojë të dhënat personale të Pajtimtarit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Qëllimet e Lejuara të Biznesit. Veçanërisht, kur të dhënat personale të Pajtimtarit mbahen në një shtet tjetër për llogari të KEMINET, siguron se niveli i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave nuk do të jetë më i vogël se ai i KEMINET.

**9.NJOHJA E KUSHTEVE NGA PAJTIMTARI**

Pajtimtari është plotësisht në dijeni të kushteve dhe pranon që përdorimi i shërbimeve prej tij duhet të bëhet në përputhje me ligjin dhe manualin ose udhëzimet përkatëse.

**10.DETYRIMET E KEMINET**

KEMINET detyrohet të njoftojë Pajtimtarin përpara nënshkrimit të formularit të kërkesës për pajtim për kushtet e përgjithshme dhe kushtet e lidhjes dhe përdorimit të shërbimeve të përcaktuara nga KEMINET, afatin e kontratës për dhënien e shërbimeve të sistemit dhe mënyrën e zgjidhjes së saj, tarifat, veçoritë e sistemit, cilësinë e shërbimeve dhe zonën e mbulimit me shërbime.

KEMINET detyrohet të pranojë dhe të shqyrtojë menjëherë çdo kërkesë ose ankesë të Pajtimtarit dhe të zgjidhë çdo çështje që ka lidhje me dhënien e shërbimeve veçanërisht për çmimet, cilësinë e shërbimeve, ndërprerjen e shërbimeve, kërkesën për dhënien e shërbimeve ose lidhjen në rrjet. KEMINET detyrohet të mbajë një dosje të të gjitha ankesave dhe kërkesave të Pajtimtarëve e cila tregon nëse ato janë zgjidhur dhe kohën që kërkohet për këtë. Dosja ruhet për një periudhë prej të paktën dy vjetësh. KEMINET detyrohet të ruajë për një afat të paktën dy vjeçar, kopje të faturave dhe t'u japë sqarime Pajtimtarëve që kanë ankesa për faturimet.

**11.PËRGJEGJËSIA NDAJ PAJTIMTARIT/PROÇEDURAT PËR KTHIMIN E PARAVE**

KEMINET ka këto përgjegjësi:

a)kur rrjeti KEMINET nuk është në gjendje t'i japë Pajtimtarit shërbimet e Internetit për një kohë të prej më shumë se 24 orësh rrjesht ose një kohë të përgjithshme prej 72 orësh gjatë një intervali të pandërprerë kohor prej 30 ditësh (përjashtuar rastet e forcës madhorë të parashikuar në pikën 18 të këtij dokumenti), KEMINET do t'i presë Pajtimtarit atë pjesë të tarifës fikse mujore të pajtimit të paguar prej tij gjatë kohës së ndërprerjes, edhe në rast se ndërprerja vjen për faj të KEMINET.

b) Kur ka vonesa prej më tepër se 3 ditë për ndreqjen e defekteve në rrjet, në rastin e pakujdesisë në ndreqjen e tyre ose ndërprerjes së pajustifikuar të shërbimeve, KEMINET detyrohet të paguaj pajtimtarët ½ e tarifës fikse mujore të paguar nga Pajtimtari.

Pajtimtari nuk ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim tjetër, përveç kësaj pagese. Kreditimi duhet të përshkruhet qartë në faturën e lëshuar në kohën kur ka ndodhur ndërprerja ose vonesa në ndreqjen e defektit.

**12.MËNYRAT E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE NËPËRMJET PAJISJEVE FUNDORE TË PAJTIMTARIT.**

Mënyrat e përdorimit të shërbimeve të dhëna nga Pajtimtari bëhen në përputhje më ligjet që lidhen me telegrafinë jokabllore dhe telekomunikacionin.

Përveç sa më sipër, Pajtimtari detyrohet:

a) të mos përdorë ose të mos lejojë persona të tretë të përdorin shërbimet e dhëna për qëllimet që bien në kundërshtim me moralin ose ligjin.
b) t'i përmbahet udhëzimeve të KEMINET për mënyrën e përdorimit të shërbimeve dhe pajisjeve fundore nga pajtimtari ose për çështje të tjera
c) t'i japë KEMINET të gjithë informacionin e duhur kur kërkohet;
d) të përdorë vetëm paisje fundore të miratuara nga Sistemi, të cilat të kenë të stampuar mbi to shenjën përkatëse të Komunitetit Europian.
e) t'i paguajë KEMINET të gjitha shumat e caktuara në kontratë, në rast se paisja fundore i humbet ose i vidhet.

Përgjegjës për mirëfunksionimin e paisjes fundore të Pajtimtarit ka vetëm prodhuesi i tij.

KEMINET informon pajtimtarët për mënyrën e përdorimit të pajisjes fundore dhe pikat e servisit ku mbështetet ky përdorim. Në rast defekti të pajisjes fundore të përdorur, pajtimtari duhet të kontaktojë menjëherë me prodhuesin ose me pikën e tij të autorizuar të shërbimit.

**13.NDËRPRERJA/SHKËPUTJA**

a)KEMINET jep shërbimet e tij 24 orë në ditë dhe për 365 ditë në vit, me përjashtim të rastit kur për një afat kohor jo më shumë se 72 orë në vit, i programuar në mënyrë të tillë që të sjellë sa më pak shqetësime tëk pajtimtarët gjatë kohëzgjatjes së ndërprerjes së shërbimeve kur nevojiten riparime për mirëmbajtjen e rrjetit duke i lajmëruar publikisht.

b) KEMINET mund të ndërpresë dhënien e shërbimeve ose kur e shikon të arsyeshme të shkëputë lidhjen e pajisjes fundore të Pajtimtarit nga rrjeti pa njoftim paraprak dhe pa mbajtur përgjegjësi, kur një gjë e tillë shkaktohet si pasojë e defekteve teknike në system, ose ndryshimeve, përmirësimeve, mirëmbajtjes së infrastrukturës, ose riparimeve të tjera të nevojshme, duke marrë masa për të kufizuar çrregullimet e mundshme në rrjet.

c)Kur Pajtimtari nuk përmbush kushtet e kontratës, (përjashtohet rasti kur pajtimtari nuk paguan në kohë detyrimet e tij) ose në rast se ai kryen ose lejon kryerjen e një veprimi që KEMINET çmon se mund të ndikojë osë vërë në rezik dhënien e shërbimeve, KEMINET mund të ndërpresë krejtësisht shërbimet (dhe me vullnetin e tij ndërpret lidhjen e pajisjes fundore të Pajtimtarit me rrjetin) duke i njoftuar me shkrim pajtimtarit kohën e arsyeshme brenda së cilës ai duket të përmbushë detyrimet.

Pajtimtari detyrohet të paguaj të gjitha detyrimet e tij për kohën e ndërprerjes së shërbimeve në rrjet, përveç rasteve kur KEMINET me vullnetin e ti, vendos ndryshe.

d) KEMINET me diskrecionin e vet mund të vendosë të ndërpresë dhënien e shërbimeve pajtimtarit pas afatit prej 15 (pesëmbedhjetë) ditësh nga data e lëshimit të faturës, nëse pajtimtari nuk ka kryer pagesën e faturës brenda ketij afati, në mënyrë që asaj mos ti shtohen shpenzime të tjera. Pajtimtarit i ngarkohen të gjitha shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, pavarësisht nëse përdorimi i shërbimeve është kufizuar.

e) KEMINET mund, që me anë të faturës së dërguar në adresën e fundit të njohur të pajtimtarit, të mbulojë shpenzimet që ka kryer për përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga pajtimtari duke përfshirë, por jo duke u kufizuar, në shpenzimet e bëra nga KEMINET për mosdhënien e informacionit të saktë të kërkuar prej pajtimtarit.

f)Me përjashtim të rasteve të shkëputjes nga rrjeti, (pika 13,c), KEMINET në varësi të rrethanave në kohën e shkëputjes ose rilidhjes mund të vendosë tarifa qër shkëputjen dhe për rilidhjen e pajisjes fundore të pajtimtarit sipas listës së çmimeve në fuqi.

**14.ZGJIDHJA E KONTRATËS NGA KEMINET**

Pavarësisht nga tërësia e të drejtave, KEMINET, mund të zgjidhë menjëherë kontratën, pa patur asnjë detyrim dëmshpërblimi, duke njoftuar me shkrim Pajtimtarin kur:

1) Pajtimtari nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje ose nga ndonjë marëveshje tjetër ndërmjet pajtimtarit dhe KEMINET
2) Pajtimtari nuk paguan detyrimet menjëherë pas kalimit të afatit të fundit prej 2(dy) muajsh nga ndërprerja e përkohëshme ose bllokimi i rrjetit, duke e njoftuar atë me shkrim.
3) Pajtimtari ndryshon emrin, statusin ligjor, falimenton, likuidohet, shpërbëhet, vendos nën administrim te detyruar ose kërkohet ndalimi i pagesave ose në raste të tjera të ngjashme, pavarësisht nëse është pajisur një kërkesë e tillë, kur pajtimtari është në gjendje paaftësie paguese ose nuk ka mundësi të paguaj kreditorët.
4) Pajtimtari kryen ose lejon kryerjen e veprimeve që mund të rrezikojne funksionimin normal të rrjetit dhe dhënien e shërbimeve
5) Licensa e KEMINET revokohet, i mbaron afati, anullohet ose ndryshohet teresisht ose pjeserisht për arsye të ndryshme.

Përves sa më sipër, në rastin e kontratës me afat të përcaktuar, KEMINET mund të zgjidhë kontratën duke njoftuar 30 ditë përpara.

**15. ZGJIDHJA E KONTRATËS NGA PAJTIMTARI**

a) Gjatë afatit fillestar të kontratës, Pajtimtarë mund të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të saj për shkaqe të arësyeshme duke njoftuar me shkrim KEMINET.

b)Në mbarim të afatit fillestar të Kontratës, pajtimtari mund të zgjidhë atë për cdo shkak duke njoftuar me shkrim KEMINET. Zgjidhja e kontratës do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit nga KEMINET. Gjithashtu zgjidhja e kontratës me efekt të menjëhershëm mund të bëhet për shkak të arsyeshëm, duke njoftuar me shkrim KEMINET.

Në përputhje më këtë nen shkak i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës është, rritja e tarifave të përdorimit të Internetit në një përqindje më të madhe sesa përqindja vjetore e inflacionit të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në muajin Dhjetor të çdo viti që i paraprin rritjes. Pajtimtari mund të ushtrojë të drejtën e tij për zgjidhjen e kontratës duke përdorur këtë shkak brenda 2 (dy) muajve nga njoftimi për rritjen e tarifave, përndryshe pajtimtari do të konsiderohet se e ka pranuar rritjen e tyre.

**16. MBARIMI I KONTRATËS**

a)Me mbarimin e kësaj kontrate KEMINET shkëput lidhjen e pajisjeve fundore të pajtimtarit nga rrjeti.

b)Pas shkëputjes së pajtimtarit nga rrjeti si pasoje e mbarimit të kontratës ai është i detyruar të paguajë me kërkesë të KEMINET të gjitha shumat e parashikuara në paragrafin 5 dhe të gjitha tarifat e papaguara në castin e shkëputjes, përfshirë edhe shpenzimet për shkëputjen nga rrjeti sipas listës së çmimeve. Në rast së mbarimi i kontratës kryhet nga pajtimtari brenda afatit fillestar të kontratës prej 3 muajsh, pajtimtari ka detyrimin ti paguaj tarifën mujore fikse për të gjithë periudhën.

**17.KALIMI I KONTARËS/KALIMI I TË DREJTAVE**

Pajtimtarët nuk mund t'ua kalojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë të tretëve, pa miratimin paraprak me shkrim të KEMINET.

KEMINET nuk mund të kalojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin ga kjo kontratë të tretëve pa pëlqimin e pajtimtari, kur kjo mund të sjellë uljen e garancisë dhë cilësisë së shërbimeve.

**18.FORCAT MADHORE**

KEMINET nuk mban përgjegjësi ndaj Pajtimtarit për shkeljen e kushteve të kontratës ose pamundësinë e tij për përmbushjen e detyrimeve të veta në rrethanat e forcës madhore.

Konsiderohet si forcë madhore: Lufta (e shpalluar ose jo), fatkeqësitë natyrore, konfliktet sociale, greva, zbatimi i planeve të urgjencës kombëtare ose lokale dhe kufizime të ofrimit të shërbimeve të vendosura me ligj, aktet e autoriteteve shqiptare, të huaja ose komunitare me fuqi ekzekutive. Pavarësisht nga rastet e forces madhore, KEMINET, do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të përmbushur sa më mirë detyrimet e tij që rrjedhin nga kontrata.

**19.NDRYSHIM I KUSHTEVE TË KONTRATËS**

a) KEMINET ka të drejtë të ndryshojë kushtet e kontratës në përputhje më legjistlacionin në fuqi dhe në mënyrë publike cis e parashikohet nga ky legjislacion.

b) KEMINET mund të ndryshojë kushtet e kontratës duke rënduar pajtimtarin vetëm në raste të veçanta dhe në raste që lidhen me ndryshime të paparashikueshme të kushteve ose forcë madhore, me përjashtim të rastit të rritjes së çmimeve kur nuk kalohet shkalla e inflacionit, e cila mund të bëhet në çdo kohë në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

c) Ndryshimet janë të vlefshme vetëm kur miratohet nga KEMINET.

**20.NJOFTIMI**

Pajtimtari është i detyruar të njoftojë KEMINET mbi të gjitha ndryshimet e të dhënave në formularin e kërkesës për pajtim. Deri në njoftimin e ndryshimeve të tilla, të gjitha fatuarat dhe dokumentet e tjera do të dërgohen në adresën e vjetër.

Çdo njoftim i dërguar Pajtimtarit nga KEMINET në përputhje me kontratën do të vlerësohet sikur është marrë brenda 48 orëve nga data e dërgimit. Përsa i përket dërgimit të faturave nëpërmjet shërbimit postar apo shërbimeve të tjera, ato do të vlerësohen se janë marrë 10 ditë nga data e lëshimit të tyre.

Të gjitha afatet kohore në ditë të përcaktuara në këtë kontratë janë të shprehura në ditë kalendarike.

**21.TËRËSIA E MARRËVESHJES**

Kjo kontratë është marëveshje e plotë dhe e vetme midis KEMINET dhe pajtimtarit dhe zëvendëson të gjitha marrveshjet e mëparshme gojore ose më shkrim me KEMINET.

**22.ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Kjo kontratë i nënshtrohet legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet KEMINET dhe pajtimtarit, kur nuk zgjidhen me mirëkuptim, do tu paraqiten për zgjidhje gjykatave kopetente shqiptare.

**23.TITUJT**

Titujt e kushteve të kontratës janë vetëm orientues dhe nuk ndikojnë në interpretimin e përmbajtjes së tyre.

**24.NJOHJA E KUSHTEVE NGA PAJTIMTARI DHE DHËNIA E GARANCIVE PREJ TIJ**

Pajtimtari njeh dhe pranon pa rezerva se kushtet e kësaj kontrate dhe lista e çmimeve në fuqi, së bashku me ndryshimet që mund ti ketë bëra asaj KEMINET herë pas here, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për faturimin e tij nga KEMINET dhe se çdo faturë mujorë për shërbimet e dhëna(tarifa fikse,tarifat e bisedave e komunikimeve telefonike dhe tarifave shtesë) e lëshuar në përputhje më pikën 5 është provë e pakundërshtueshme e detyrimeve të tij ndaj KEMINET. Çdo kundërshtim i pajtimtarit për detyrimet e sipërpërmendura duhet të bëhet më shkrim, të jetë i arsyetuar dhe do t'i dorëzohet KEMINET brenda afatit të parashikuar në pikën 5 të këtij dokumenti. Pajtimtari deklaron këtu se heq dorë shprehimisht nga pretendimet për detyrimet nëqoftë se nuk bën ankim brenda afatit të parashikuar në pikën dhe se është i vetmi personqë përgjigjet për pagimin e faturës, si dhe dorëzanësi kur ka të tillë, pa qënë nevoja për njoftim të veçantë, me shkrim, dhe pa pasur të drejtën e përfitimit nga shfajësimi ose ndarja e detyrimit.

PAJTIMTARI

Mora dijeni të plotë dhe i pranoj të gjitha kushtet e kësaj kontrate

___________________________________________________________